

VLADIMIR I. GEORGIEV

## ILIRËT DHE FQINJËT E TYRE

Deri para dyzet vjetësh mendimi mbizotërues ishte që në Gadishullin ballkanik në veri të Greqisë do të jetë folur një gjuhë e vetme ose dialekte të një gjuhe të vetme, megjithëse ne përdorim termin «trako-ilirishte». Më vonë, megjithatë është përcaktuar në mënyrë definitive që, megjithëse të afërta, ilirishtja dhe trakishtja janë dy gjuhë indo-evropiane mjaft të ndryshme njëra nga tjetra, pak a shumë ashtu si latinishtja dhe iranishtja.

Nga ana tjetër, deri para pesëmbëdhjetë vjetësh termi «trakishte» shërbente për të shënuar gjuhën e popullsisë së vjetër që banonte territorin e gjerë, i cili shtrihej që nga Karpatet Veriore në mes të lumenjve Tisa dhe Dnjestër (ose Dnjepër), pjesën lindore të Gadishullit ballkanik në lindje të lumenjve Morava dhe Vardar, si dhe disa krahina në Azinë e Vogël veriore dhe qendrore, do me thënë territoret e sotme të Ukrainës perëndimore, të Moldavisë, gjithë Rumaninë, Hungarinë Lindore, Jugosllavinë Lindore, gjithë Bullgarinë, verilindjen e Greqisë, Trakinë turke dhe krahinat e gjëra të Turqisë Veriore dhe Qendrore.

Ne e pranonim këtë koncept duke u besuar informatave të gjeografit Strabon dhe të autorëve të tjerë të vjetër, të cilët deklarorin që Dakët dhe Frigasit ishin fise trake dhe që ata flisnin gjuhën trake. S'ka dyshim se që nga periudha më e hershme antike janë folur gjuhë me origjinë indoevropiane në krahinat e përmendura. Por koncepti i fqinjësisë gjuhësore është një zbulim i shekullit XIX. Autorët e vjetër nuk kanë pasur asnjë ide për gjuhësinë e krahasuar. Ata bënin këtu të njejtin gabim si atëhere kur pohonin që latinishtja është një dialekt eolian i greqishtes.

Në të vërtetë trakishtja, frigishtja dhe dakishtja kanë qenë tri gjuhë indoevropiane të ndryshme. Ky është një fakt i përcaktuar nga studimi i shpërndarjes së toponimeve në këtë krahinë, i më se 150 mbishkrimeve frigase dhe i ndryshimeve leksikore të gjuhëve të përmendura.

Një ndryshim i tillë rrënjësor është shkaktuar gjithashtu në këto dy dhjetëvjeçarët e fundit në lidhje me gjendjen etnike të vjetër në pjesën perëndimore të Gadishullit.

Deri para dhjetëvjetësh, bile pas përmbysjes së tezës paniliriane të H. Krahes, mendohej që pjesa perëndimore e Gadishullit ballkanik e shënuar nga administrata romane nën zotërimin e provincës *Illyricum* që përfaqëson afërsisht Shqipërinë, Jugosllavinë (duke përjashtuar Maqedoninë) dhe një pjesë të Hungarisë Jugore (Panoninë e vjetër) të sotme, ka qenë e banuar nga një popullsi ilire homogjene. Me-

gjithatë R. Katiçiç duke përdorur disa konkluzione të bashkatdhetarit të tij D. Rendiç-Mioçeviç, ka treguar që antroponimia e vjetër e kësaj krahine të gjerë nuk është homogjene. Duke u bazuar tek antroponimia mund të përcaktohen këtu tri krahina të ndryshme etnike.

Një grup antroponimesh është karakteristik veçanërisht për pjesën ilire të provincës romane të Maqedonisë dhe të juglindjes së Dalmacisë, do me thënë për pjesën që përfshin afërsisht Shqipërinë e sotme dhe pjesën jugperëndimore të Jugosllavisë Jugore. Emra të tillë njerëzish janë: *Bardylis, Bardeias, Clevas, Epicadus, Gentius, Glavos, Grabon, Grabos, Laid(i)us, Longarus, Monunis, Pinnes, Plassus, Pleuratus, Skerdilaidas, Scerdis, Temus, Temcia, Temans, Teuta, Teutana, Teutamos, Verzo, Verzaius, Zanatis* dhe të tjerë. Kjo është krahina e Ilirisë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, *Illyrii proprie dicti*.

Një grup tjetër antroponimesh është i përhapur kryesisht në Dalmacinë Qendrore (Mitteldalmatien). Emra të tillë janë: *Andes, Aplis, Aplo, Baezus, Boracio, Barcinus, Baurea, Boria, Benn(i)us, Beuzas, Buzetius, Biso, Bubant, Carp(i)us, Carvus, Cursulavia, Dasant, Dasto, Dasomenus, Dasius, Ditus, Germanus, Germus, Iettus, Lavius, Paius, Pannes, Panto, Pinsus, Pladonunus, Planus, Prevo, Samuntius, Scaeva, Scenobarbus, Sceno, Scenocalus, Seia, Sinus, Stennas, Sutta, Testo, Tizius, Tritanus, Tudania, Varro, Vendo* e të tjerë.

Një grup i tretë antroponimesh është karakteristik veçanërisht për krahinën e Liburnëve të vjetër, do me thënë për territorin e Jugosllavisë së sotme Veriperëndimore. Emra të tillë janë: *Aetor, Aplus, Ceunus, Darmocus, Oeplus, Oia, Opiavus, Oplia, Oplus, Raccus, Suioca, Vadicus, Vescleves-, Veturia, Viniocus, Volso, Voltissa* dhe të tjerë.

Mbi bazën e këtyre tre grupeve të antroponimeve të përcaktuar mjaft mirë nga pikëpamja gjeografike, R. Katiçiç ka arritur me të drejtë në konkluzionin që është fjala për tri krahina etnike të ndryshme: Iliria (në kuptimin e mirëfilltë të fjalës), Dalmacia Qendrore dhe Liburnia.

Për më tepër, të dhëna të ndryshme tregojnë në mënyrë të qartë që gjuha e liburnasve është shumë e afërt ose bile identike me atë të venetëve. Por, që prej njëzet vjetësh është përcaktuar tashmë që venetishtja nuk mund të identifikohet me ilirishten: ajo përfaqëson një gjuhë indoevropiane të veçantë në fqinjësi shumë të afërt me latinishten. Si rrjedhim, liburnishtja nuk mund të konsiderohet si një dialekt ilir.

Kështu, mbi bazën e të dhënave të onomastikës dhe të gjeografisë historike, janë përcaktuar në pjesën veriore dhe qendrore të Gadishullit ballkanik, që dikur konsiderohej i banuar, gjatë antikitetit, nga një popullsi pothuajse homogjene nga pikëpamja gjuhësore, tetë krahina etnike të ndryshme: Dako-Mize, Trake, Protofrigase, Maqedonase, Ilire, Dalmate, Liburne (dhe Venete), Panonase (nga e cila njihen shumë pak gjëra).

## II

Në qoftë se duam të kemi një ide të qartë për gjuhën ilire të studjojmë në mënyrë sistematike onomastikën e vjetër të territorit të sotëm të Shqipërisë dhe atë të Jugëperëndimit të Jugosllavisë, afërsisht

krahinat midis lumenjve të Neretvës dhe të rrjedhës së sipërme të Ibarit, si dhe Maqedoninë perëndimore.

Në këtë krahinë ilire *stricto sensu* mund të përcaktojmë dy tipe *onomastike* (toponime, hidronime, oronime, antroponime dhe etnonime):

1. Gjenden këtu shumë emra vendesh, njerëzish dhe tribush (fishesh) që përmbajnë zanoren *o*. Megjithëse etimologjia e tyre nuk është gjithnjë krejt e sigurtë, megjithatë në pjesën më të madhe të rasteve është e qartë që zanorja e përmendur vjen nga zanorja indoevropiane *o* e shkurtër, për shembull:

Emra vendesh: *Alkomenai, Bolouros, Codrio(ue), Dibolia, Dio-, Docl(e)a, Damavia, Loranum, Oidantion, Olbia(gr.?), Oneum (Onaion), Orgomenai, Orgessos, Scodra (mons), Tomaros.*

Emra njerëzish: *Kopaina, Longarus, Monounios, Morkos.*

Emra fisesh: *Eordaioi, Onastini.*

Nga ana tjetër, gjenden bile, toponime, antroponime dhe etnonime që përmbajnë zanoren *a* që vjen, ka shumë të ngjarë, nga zanorja indoevropiane *o* e shkurtër, për shembull:

Emra vendesh: *Clausal(a) (fl.), Dimallum (Dimale), Maluntum, Naron (fl), Narona, Panyasos (fl) Scardon (mont).*

Emra njerëzish: *Bardylis, Bardeias.*

Emra fisesh: *Narensii, Parthini, Taulanti, Daulantion (ethnos).*

Emrat e këtij tipi janë më të pakët. Përsa i përket trajtimit të zanores indoevropiane *o* të shkurtër gjuhët indoevropiane mund të ndahen në dy grupe:

1. Gjuhë që e ruajnë zanoren *o* të shkurtër: keltishtja, italike (latinishtja dhe osko-umbishtja) venetishtja (dhe liburnishtja), maqedonishtja, frigishtja, armenishtja dhe greqishtja.

2. Gjuhë indoevropiane që kanë ndryshuar zanoren *o* primitive të shkurtër në *a*: gjermanishtja, baltosllavishtja (*o* e gjuhëve sllave vjen nga *a*-ja, e shkurtër protosllave), dakishtja, shqipja, mesapishtja, trakishtja, pelasgishtja, indo-iranishtja dhe hititoluvishtja. Përsa i përket tokarishtes trajtimi normal i zanores primitive *o* e shkurtër është *a*, megjithatë ka disa raste ku del zanorja *o*. Duket që këtu fjala është për një përzierje gjuhësh indoevropiane ose më mirë për një evolucion sekondar.

Është një gjë e ditur që Protofingasit kanë kaluar në Azinë e Vogël duke ardhur nga Maqedonia Veriperëndimore dhe që Protoarmenët, gjuha e të cilëve përmban një komponente frigase, vijnë, gjithashtu edhe ata, nga një krahinë fqinje e pjesës qendrore të Gadishullit ballkanik.

Pra, sipas trajtimit të zanores primitive *o* e shkurtër, gjuhët indoevropiane ndahen në dy grupe mjaft të përcaktuar nga pikëpamja gjeografike: gjuhë perëndimore dhe gjuhë lindore.

Por, në periudhën e hershme antike ilirishtja shtrihej në veri të greqishtes dhe në perëndim të maqedonishtes dhe të protofrigishtes, të cilat janë gjuhë ku zanorja indoevropiane *o* e shkurtër është ruajtur. Në veriperëndim ilirishtja ishte fqinje me dalmatishten që nuk njihet mirë, por më në veriperëndim venetishtja (dhe liburnishtja) është një gjuhë, që gjithashtu ka ruajtur zanoren primitive *o* të shkurtër. Në verilindje ilirishtja ishte fqinje me dakomijzishten ku *o* e shkurtër primitive është shëndruar në *a*.

Si rrjedhim, nëqoftëse gjejmë në onomastikën ilire shumë toponime, antroponime, dhe etnonime me zanoren indoevropiane *o* e shkurtër, kjo nuk është e rastit. Kjo provon që në krahinat ilire ka një shtresë gjuhësore që karakterizohet nga zanorja indoevropiane *o* e shkurtër e ruajtur, ashtu si në greqishte, në maqedonishte, në frigishte dhe në venetishte.

Nga ana tjetër, në Ilirinë e vjetër gjendet një tjetër shtresë gjuhësore në të cilën zanorja indoevropiane *o* e shkurtër është shndërruar në *a*, ashtu si në shqipe, në dakomizishte dhe në trakishte.

Çështjet që shtrohen tani janë: Cila nga këto dy shtresa ka të drejtën të quhet ilirishte dhe cila është baza e gjuhës shqipe?

Në gjuhën shqipe zanorja indoevropiane *o* e shkurtër del si *a*. Baza e shqipes është pra shtresa gjuhësore në Iliri, ku zanorja primitive *o* e shkurtër është kthyer në *a*. Nëqoftëse e përcaktojmë këtë shtresë të vjetër si ilirishte, mund të bëhen konkluzionet e mëposhtme: ilirishtja është paraardhësja e gjuhës shqipe, do me thënë ilirishtja është baza, gjuha nënë e shqipes. Në këtë rast duhet të pranojmë që në Ilirinë e vjetër ka pasur një substrat preilir me origjinë indoevropiane që do të mund të përcaktohej si një komponent i vjetër i gjuhës shqipe.

Nga ana tjetër, po të ruajmë emërtimin e ilirishtes për substratin duhet të bëjmë konkluzionin e mëposhtëm: gjuha shqipe është me origjinë dakomyze (dardaniane) ndërsa ilirishtja s'është veçse një komponente e shqipes. Po të marrim në konsideratë që emrat e maleve të dakëve *Carpates* dhe *Beskides* dhe shumë emërtime bimësh dake në veprat e Dioskoridit dhe të Pseudo-Apulesë si, përshembull, *amalusta*, *diky*, *zonoustër*, *mantia*, *sipotax*, *skiare*, mund të shpjegohen me ndihmën e gjuhës shqipe, supozimi i dytë duket më i besueshëm.

\* \* \*

Në këtë kumtesë të shkurtër e kam thjeshtuar në mënyrë të ndër-gjegjshme problemin e gjuhës ilire. Pa dyshim, ai është shumë më i komplikuar dhe më i vështirë për t'u zgjidhur në mënyrë përfundimtare, sepse të dhënat që kemi nga Antikiteti janë krejt të pamjaftueshme. Megjithatë kërkimet e mëvonshme mund të kontribuojnë për të ndriçuar këtë problem të rëndësishëm për gjuhësinë dhe për historinë.

### R é s u m é

#### LES ILLYRIENS ET LEURS VOISINS

##### I.

Le thrace, le phrygien et le dace ont été trois langues indo-européennes différentes. C'est un fait établi par l'étude de la distribution des toponymes dans cette région, des plus de 150 inscriptions phrygiennes et des divergences lexicales des langues mentionnées.

Jusqu'à il y a une dizaine d'années, même après l'écroulement de la thèse panillyrienne de H. Krahe, on croyait que la partie occidentale de la Péninsule

balkanique désignée par l'administration romaine sous la dénomination de province *Illyricum* serait habitée par une population illyrienne homogène. Cependant, V. Katičić, mettant à profit certaines conclusions de son compatriote D. Rendic-Miočević, a démontré que l'anthroponymie ancienne de cette vaste région n'est pas homogène. Il définit trois régions ethniques différentes.

Un groupe d'anthroponymes est caractéristique surtout pour la partie illyrienne de la province romaine de Macédoine et du Sud-Est de la Dalmatie, c'est-à-dire la partie qui comprend approximativement l'Albanie actuelle et la partie Sud-Ouest de la Yougoslavie méridionale. C'est la région de l'Illyrie proprement dite, les *Illyrii proprie dicti*. Un autre groupe est diffusé principalement dans la Dalmatie centrale. Un troisième groupe est caractéristique surtout pour la région des anciens Liburniens, c'est-à-dire du territoire de la Yougoslavie actuelle du Nord-Ouest.

Sur la base de ces trois groupes d'anthroponymes, géographiquement bien délimités, R. Katičić a justement conclu qu'il s'agit de trois régions ethniques différentes: Illyrie (proprement dite), Dalmatie centrale et Liburnie.

Ainsi, sur la base des données de l'onomastique et de la géographie historique on a délimité dans les parties septentrionale et centrale de la Péninsule balkanique, que l'on considérait jadis peuplée pendant l'antiquité par une population presque homogène du point de vue linguistique, huit régions ethniques différentes: Daco-Mysiens, Thraces, Protophrygiens, Macédoniens, Illyriens, Dalmates, Liburniens (et Vénètes), Pannoniens (dont on ne sait que très peu).

## II.

Si l'on voudrait avoir une idée claire de la langue illyrienne on doit étudier systématiquement l'onomastique ancienne du territoire actuel de l'Albanie et celui du Sud-Ouest de la Yougoslavie. Dans cette région illyrienne *stricto sensu* on peut délimiter deux types onomastiques:

1. On trouve ici beaucoup de noms de lieux, de personnes et de tribus qui contiennent la voyelle *o*, qui remonte à la voyelle indo-européenne de l'*o* bref: *Alkomenai*, *Kopaina*, *Eordaioi*, etc.

2. D'autre part, on y trouve, de même, des toponymes, des anthroponymes et des ethnonymes qui contiennent la voyelle *a*, montrant très probablement à l'*o* bref i.-e.: *Clausal(a)*, *Bardylis*, *Narensii*, etc. Ils sont moins nombreux.

A propos de l'*o* bref des langues indo-européennes, on peut séparer deux groupes:

1. Langues qui gardent l'*o* bref: le celtique, l'italique, le vénète, le macédonien, le phrygien, l'arménien et le grec.

2. Langues qui ont changé l'*o* bref en *a*: le germanique, le balto-slave, le dace, l'albanais, le messapien, le thrace, le pélasgique, l'indo-iranien et le hittite-louvite.

Donc, d'après le traitement de la voyelle primitive *o* bref, les langues indo-européennes se divisent en deux groupes géographiquement bien délimités: langues occidentales et langues orientales.

Or, dans la haute antiquité, l'illyrien était situé au nord du grec et à l'ouest du macédonien et du protophrygien qui sont des langues où la voyelle indo-européenne *o* bref est conservée. Au nord-ouest, l'illyrien était voisin du dalmate qui est mal connu, mais plus au nord-ouest le vénète (et le liburnien) est une langue qui, elle aussi, a conservé la voyelle primitive *o* bref. Au nord-ouest l'illyrien était voisin du daco-mysien dans lequel l'*o* bref primitif est changé en *a*.

Par conséquent, si l'on trouve dans l'onomastique illyrienne beaucoup de toponymes, d'anthroponymes et d'ethnonymes avec la voyelle indo-européenne *o* bref conservée, ce n'est pas fortuitement. Cela prouve que dans la région illyrienne il y a une couche linguistique qui se caractérise par la voyelle indo-européenne *o* bref conservée, de même qu'en grec, en macédonien, en phrygien et en vénète.

D'autre part, on trouve dans l'Illyrie ancienne une autre couche linguistique dans laquelle la voyelle indo-européenne *o* bref est changée en *a*, de même qu'en albanais, en daco-mysien et en thrace.

Les questions qui se posent maintenant sont: laquelle de ces deux couches a le droit d'être appelée illyrienne et quelle est la base de la langue albanaise? En albanais la voyelle indo-européenne *o* bref apparaît comme *a*. La base de l'albanais est donc la couche linguistique en Illyrie où la voyelle primitive *o* bref est changée en *a*. Si l'on détermine cette couche ancienne comme illyrienne, on peut faire la conclusion suivante: l'illyrien est l'ancêtre de la langue albanaise, c'est-à-dire l'illyrien est la base, la langue-mère de l'albanais.

D'autre part, si l'on garde la dénomination de l'illyrien pour le substrat on doit faire la conclusion suivante: la langue albanaise est d'origine daco-mysienne (dardanienne) et l'illyrien n'est qu'une composante de l'albanais. Si l'on prend en considération que les noms de montagnes daces *Carpatas* et *Beskides* et plusieurs des dénominations des plantes daces dans les ouvrages de Dioscoride et de Pseudo-Apulée peuvent être expliquées à l'aide de la langue albanaise, la seconde supposition paraît plus vraisemblable.